



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 7
Prishtinë, më 13 maj 2011, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Sabri Hamiti dhe Shaip Muja.

Munguan: Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Amir Ahmeti dhe Petar Miletqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumije Murati –ZPRK, Sanije Berisha – OSBE, Isuf Zejna dhe Shkelzen Lushaku- KDI.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Elfete Alshiqi - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t e :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të datës 27 prill 2011;
3. Takim me ministrin Enver Hoxhaj, rreth njohjeve të reja;
4. Miratimi i propozimit për MPJ- në lidhur me përfaqësimin reciprok ose të përbashkët mes Kosovës e Shqipërisë;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës me heqjen e pikës së tretë, pasi që ministri Enver Hoxhaj nuk ka mundur t'i përgjigjet ftesës për shkak të angazhimeve jashtë vendit.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 27 prill 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e datës 27 prill 2011, me vërejtjet e deputetëve: Sh. Muja, H. Hyseni dhe E. Kervan.

Shaip Muja - Tha se me rastin e kërkesës për bartjen e pikës 4. a) si pikë të parë të rendit të ditës është dashur të shkruhet arsyetimi si vijon: Kam bërë një vërejtje në drejtim të sjelljes së kryetarit të Komisionit për Punë të Jashtme dhe keqpërdorimit zyrtar të pozitës që përdor dhe në drejtim të sekretarisë për formulimin e ftesave autoriteteve zyrtare të Republikës së Kosovës.

Hydajet Hyseni- Tha se procesverbali nëse pretendon të përfshijë edhe diskutimet gjithmonë do të ketë mangësi, sepse nuk ka mundësi të përfliten diskutimet, e mandej të mos ketë vend për vërejtje. Zgjidhja është që procesverbali të përfshijë vetëm mendimet, propozimet eventualisht argumentet kryesore për një propozim. E mira është që të incizohet mbledhja dhe transkripti, të nxirret nëse ka nevojë. Tash kemi diçka mes procesverbalit e transkriptit e nuk kemi as njërin as tjetrin p.sh. në pjesën time kam theksuar “Është e drejtë e kryetarit ta caktojë rendin e ditës dhe ta formulojë. Ne pastaj i shqyrtojmë dhe i miratojmë, nëse kemi vërejtje nuk pajtohemi” kjo nuk është përfshirë, e konsideroj një konstatim që duhet të përfshihet me çdo kriter.

Enis Kervan - Tha se në diskutimin e tij, është dashur të shkruhet edhe arsyetimi pse e ka kërkuar informatën, si vijon: Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri tha se do t’ia dorëzoj Platformën e bisedimeve kryetarit të Kuvendit pas kthimit të tij nga Brukseli dhe pastaj Komisionit, si dhe po të njëjtën ditë do t’i dërgojë edhe emrat e ekspertëve dhe të dhënat e tjera lidhur me dialogun.

3. Miratimi i propozimit për MPJ- në lidhur me përfaqësimin reciprok ose të përbashkët mes Kosovës e Shqipërisë

Albin Kurti - Tha se në mbledhjen e kaluar kemi diskutuar për iniciimin e një marrëveshjeje mes Kosovës dhe Shqipërisë për përfaqësim reciprok ose të përbashkët.

Ne, të gjithë, u pajtuam në parim për këtë lloj përfaqësimi, dhe u akordua që ta bëjmë një propozim me shkrim. Ne e kemi një formë të propozimit me shkrim që ta shqyrtojmë, dhe pasi ta miratojmë t’ia përcjellim Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Lidhur me përmbajtjen e draft- propozimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme lidhur me përfaqësimin reciprok ose të përbashkët mes Kosovës dhe Shqipërisë diskutuan deputetët: A. Kurti, H. Hyseni, E. Kervan, S. Hamiti dhe Sh. Muja.

Pas diskutimeve kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundimin

- 1. I propozohet Ministrisë së Punëve të Jashtme që të iniciojë një marrëveshje në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për përfaqësim reciprok ose të përbashkët në vendet e treta.*
- 2. Iniciativa të parashihet në dokumentet e Ministrisë së Punëve të Jashtme: Dokumentin për Politikë të Jashtme, në Programin e Aktiviteteve të Ministrisë së Punëve të Jashtme për vitin 2011-2014, si dhe Strategjisë për Lobim.*
- 3. Propozimi t’i përcillet edhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Komisionit për Politikë të Jashtme të Shqipërisë përmes Ambasadës së Shqipërisë në Kosovë.*

4. Të ndryshme.

Albin Kurti - Tha se nuk kemi informacion në bazë të nenit 74 të Rregullores, për takimet e deputetëve jashtë vendit. Për diplomaci parlamentare të Kuvendit janë ndarë 500 mijë euro, ajo po

ndodh pa u iniciuar formalisht dhe pa u njoftuar për të. Kishte qenë mirë që çdo gjashtë muaj të kemi nga një raport mbi diplomacinë parlamentare.

Sabri Hamiti – I njoftoi se çështja e udhëtimeve jashtë vendit, vizitat e komisioneve të Kuvendit është provuar të koordinohen përmes Komisionit për Punë të Jashtme, por nuk ka hasur në mirëkuptim. Tani vizitat zyrtare sipas Rregullores lejohen përmes Kryesisë, dhe pas përfundimit të vizitës Raporti nga vizita i përcillet Kryesisë. Distribrimi i Raportit nga vizita për deputetët e Kuvendit është çështje tjetër. Në raportet e udhëtimeve jashtë vendit tha se ky Komision është dashur dhe duhet ta ketë një natyrë më të fuqishme.

Hydajet Hyseni - Tha se së pari duhet ta sqarojmë çka është diplomacia parlamentare. A është çdo aktiviteti i komisioneve diplomaci parlamentare, pasi shumë komisione me komisionet homologe këmbëjnë përvoja nga fusha e veprimit të tyre. Koordinimi i lëvizjeve parlamentare duhet bërë nga Kryesia, nuk mund të ketë rangim të komisioneve, po ashtu tha se pajtohem që deputetët duhet të njoftohen për lëvizjet parlamentare që bëhen.

Shaip Muja - Për realizimin e vizitave në mënyrë më praktike, tha se është mirë që kryetarët e nënkryetarët e komisioneve ta mbajnë një takim të përbashkët dhe të sqarohen me pikat ku interferohen me prezantimet e tyre jashtë vendit ose brenda vendit, në mënyrë që të koordinohemi.

Albin Kurti - Tha se një grup deputetësh do të udhëtoj në Bruksel në muajin qershor, dhe ata do ta kenë përvojën dhe kujtesën e tyre individuale, e cila do të ndodhet sipër përvojës dhe kujtesës institucionale në mungesë të kësaj informate. Ata do të takohen me diplomatë e politikanë në Bruksel pa e ditur se kolegët e tyre janë takuar më parë me ta.

Sabri Hamiti - Tha se është domosdoshmëri e informimit me shkrim, e delegacioneve të cilat shkojnë në emër të Kuvendit dhe e përfaqësojnë Kuvendin. Kuvendi ka pasur probleme të mëdha për tipet e udhëtimeve, sepse ka raste kurrë një deputet mund të marrë një thirrje nga ndonjë organizatë që nuk është institucionale, kuvendare apo politike, por thirrje për takim. Ne kemi kërkuar që të dihet një delegacion i Kuvendit, kur të shkojë në vizitë jashtë vendit, se është përfaqësues i Kuvendit me program dhe trajtim. Delegacioni i cili tani udhëton në Bruksel nuk është i karakterit përfaqësues, kjo vizitë është e financuar nga BE-ja, me qëllim trajnimit dhe të njohjes me përvojat e Brukselit.

Hydajet Hyseni - Tha se çështja e koordinimit jashtë vendit mund të shtrohet edhe në takimin me kryetarin e Kuvendit dhe kryetarët e Komisionit, në mënyrë që Komisioni të informohet dhe pastaj të dallojmë përfaqësimet e Kuvendit prej përfaqësimeve të tjera.

Shaip Muja - Lidhur me takimin me delegacionin nga Parlamenti holandez tha se ne u takuam me delegacionin dhe e kishim vetëm një listë të emrave të delegacionit, por nuk kishim informacione se me kënd po takohemi dhe qëllimin e takimit. Propozoi që herëve të tjera para takimeve me delegacione të huaja, Komisioni të takohet për të ditur se me kënd po takohet, qëllimet e takimit, benefitet që mund t'i përfitojmë dhe, si Komision, për çfarë mund të dalim në mënyrë unike dhe të ndarë. Ne mund të dallojmë me ngjyrimet politike, por në çështjet e mëdha kombëtare është mirë të jemi unik.

Hydajet Hyseni - Tha se në takimet me delegacione duhet të kërkojmë t'i kemi informacionet plotësuese për delegacionet, dhe ta bëjmë një takim strategjik të Komisionit para këtyre takimeve.

Sabri Hamiti - Tha se për delegacionin dosjet dhe informacionet janë bërë dhe për çdo takim me delegacionet informacionet i përgatit zyra për protokoll dhe marrëdhënie ndërkombëtare e Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti